



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 103/5 prot.

Tiranë, më 22.05.2024

V E N D I M

Nr.34, datë 22/05/2024

Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me situatën e administrimit të shërbimit civil në institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

VËREJ SE:

Me urdhrin nr. 20, datë 30.1.2024 “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar procesin e mbikëqyrjes për zbatimin e ligjshmërisë gjatë aplikimit të instituteve të ligjit për nëpunësin civil, në institucionin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 103/1 prot., datë 30.1.2024, të miratuar nga Komisioneri, i cili i është njoftuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me

shkresën nr. 103/2 prot., datë 30.1.2024 “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 103/3 prot., datë 22.4.2024 “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”, duke i lënë afat 5 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, përgjatë gjithë periudhës së kontrolluar, Komisioneri ka evidentuar disa mangësi në drejtim të administrimit të procesit të rekrutimit apo të vlerësimit të punës, të cilat janë trajtuar me hollësi në raportin përfundimtar, por që nuk çënojnë thelbin e proceseve të realizuara dhe në disa raste, ato janë korrigjuar nga vet institucioni gjatë procesit të mbikëqyrjes.

Subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projektraportin nëpërmjet shkresës së Komisionerit me nr. 103/3 prot., datë 22.4.2024, e ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, pa vërejtje, duke u shprehur dakord me gjetjet e grupit të punës të pasqyruara në të.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, konstatova se, parregullsitë e konstatuara nuk janë të natyrës së shkeljeve ligjore që kërkojnë rregullime të posaçme për proceset e përfunduara, por duhet të mbahen parasysh gjatë proceseve në vijim, nga subjektet e evidentuara në raportin e mbikëqyrjes.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, e ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil në institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të përfundoj procesin e mbikëqyrjes në këtë institucion.

Gjetjet e evidentuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar, kanë të bëjnë me aspekte të përgjithshme të zbatimit të ligjit, e për këtë arsye, Komisioneri do të përmbyllë procesin pa

vendim paralajmërues. Ecuria e mëtejshme e proceseve dhe ndjekja e zbatimit të ligjit në proceset me natyrë të ngjashme që do të kryhen rishtas, do të jetë në vëmendjen e vazhdueshme të stafit të Komisionerit.

2. Për këtë vendim të njoftohet Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, duke i dërguar një kopje të Raportit Përfundimtar, si dhe të vendimit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha